



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:286112

Datë: 17.11.2023

Numri i dokumentit: 04934399

C.nr.3994/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri, në çështjen kontestimore të paditëses H.B, nga Prishtina, Lagja .... Bll....., Hyrja ....., nr..... Prishtinë, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson F.B- Xërxa, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.Gj, me objekt kontesti kompensim i pagave dhe të ardhurave tjera nga marrëdhënia e punës, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 31.10.2023, më datë 17.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses H.B, , ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës si mësimdhënëse e lëndëve të Stomatologjisë në SHMM “Dr.Ali Sokoli” Prishtinë, t’ia paguaj për periudhën kohore nga data 01.09.2014 deri me datë 28.02.2018, në emër të pagave të papaguara shumë prej 12,873.61€ neto, dhe atë me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e ushtrimit të padisë datë 01.07.2016, e gjer në pagesën definitive të detyrimit, në emër të kontributeve pensionale shumë prej 750.25€ në llogarinë e paditëses në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe në emër të tatimit në pagë shumë prej 1,381.07€ në Administratën Tatimore të Kosovës, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 250.00 euro, dhe atë në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Rrethanat e çështjes kontestimore:

Paditësja në këtë gjykatë, me datë 01.07.2016 ka paraqitur padi për kompensim të të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit Prishtine. Lidhur me këtë lëndë, gjykata ka zhvilluar procedurën kontestimore në drejtim të vendosjes meritorie dhe me datën 22.01.2020 ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.1469/2016, me të cilin në tërësi

e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëse. Bazuar në procedurën ankimore të zhvilluar sipas ankesës së të paditurës, Gjykata e Apelit ka gjetur ankesën të bazuar dhe përmes Akvendimit AC.nr.3066/2020 të datës 21.06.2023 e ka prishur aktgjykimin C.nr.1469/2016, të datës 22.01.2020 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Pas pranimit të aktvendimit të Gjykatës së Apelit, me qëllim të eliminimit të vërejtjeve të dhëna në të njëjtin, gjykata ka caktuar seancë përgatitore për datën 11.09.2023, në të cilën seancë ka prezantuar e autorizuar e paditëses, ndërsa për të paditurën askush edhe pse e njëjta ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt dhe në mungesë të saj e me propozimin e të autorizuarës së paditëses, seanca në fjalë është mbajtur në mungesë të të paditurës, konform nenit 409 par.2 të LPK-së.

*Pretendimet e palëve në procedurë:*

E autorizuar e paditëses lidhur me padinë dhe kërkesëpadinë është deklaruar se qëndron në tërësi pranë të njëjtës, ashtu që në padi dhe në seancat e kaluara ka theksuar se paditësja është e diplomuar në Fakultetin Mjekësisë – Drejtimi i Stomatologjisë dhe është specializante e kësaj fushe dhe se ka qenë e punësuar si profesoreshë e lëndëve të stomatologjisë në Shkollën e Mesme të Mjekësisë Dr.Ali Sokoli në Prishtinë nga data 01.09.2009 deri me datë 01.09.2014 dhe me fillimin e vitit shkollor 2014/2015 paditësja ka mbetur pa orë mësimi në këtë shkollë. Në ndërkohë në bazë të procedurave administrative të iniciuara nga paditësja e njëjta me vendim të Sekretarit të MASHT paditësja është kthyer në vendin e punës dhe pas inicimit të procedurës përmbartimore, me vendimin e datës 17.01.2018, Komuna e Prishtinës respektivisht Kryetari i Komunës, ka aprovuar urdhrin përmbartimor për kthim në vend të punës dhe paditësja është kthyer në pozitën mësimdhënëse e lëndëve të stomatologjisë në SHML Ali Sokoli në Prishtinë.

Pas zgjidhjes së kontestit lidhur me kthim në vendin të punës, paditësja ka me datë 30.05.2018 përmes parashtresës ka bërë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që tani objekti i kontestit sipas kësaj lënde do të zhvillohet vetëm për kompensimin e të ardhurave personale në mënyrë retroaktive për periudhën 01.09.2014 deri me datë 28.02.2018 pasi që paditëses për këtë periudhë nuk i janë paguar pagesa e pagave mujore, trusti pensional, dhe tatimi në pagë. Ka theksuar se paditësja është larguar nga puna pa asnjë vendim, mirëpo më vonë pa u kthyer ende në punë për periudhën 1 vjeçare prej datës 01.09.2014 deri me datë 31.08.2015 e paditura ia ka paguar vetëm 50% të pagës mujore. Ka shtuar se paditësja deri në kohën kur është larguar nga puna ka pas pagë mujore prej 454.77€, andaj për vërtetim të lartësisë së kërkesëpadisë i ka propozuar gjykatës që të caktohet një ekspert nga lëmia e financave me qëllim që të bëjë kalkulimin e pagave të papaguara nga e paditura për periudhën prej 01.09.2014 deri me 31.08.2015 në lartësi prej 50% të pagës bazë dhe 50% të kamatës, pasi që 50% e paditura i'a ka paguar paditëses vullnetarisht, ndërsa prej datës 01.09.2015 deri me datë 28.02.2018 të bëjë llogaritjen e plotë të pagës në shumë 454.77€ si dhe kamatën. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prishtinës Drejtoria e Arsimit, përmes përfaqësuesve të saj, me përgjigje në padi, me deklaratimet e dhëna gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditëses nën pretendimin se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat e ndryshimit të profilit arsimor në shkollën

profesionale ‘‘Dr. Ali Sokoli’’ në Prishtinë, nga e cila ka ardhur deri zvogëlimi i numrit të orëve të domosdoshme të punës për lëndët mësimore – teknik i dhëmbëve, në të cilën lëndë paditësja ka pasur marrëdhënie pune me kontratë në afat të caktuar pune prandaj edhe në bazë të vendimit të MASHT nr. 2114, datë 07.07.2016, paditëses i është aprovuar ankesa për kthim në vendin e punës por jo edhe kompensimi i të ardhurave personale për periudhën kontestuese sa e njëjta ka qenë e papunë. Tutje ka kundërshtuar kërkesën e paditëses për kompensimin nga marrëdhënia e punës për faktin se paditësja ka pas kontratë të punës për kohë të caktuar dhe me vendimin me të cilin është kthyer në vendin e punës nuk i është njohur edhe e drejta në kompensim të të ardhurave personale. Prandaj nga sa u tha më lartë, i ka propozuar gjykatës që padinë ta refuzojë si të pabazuar.

### Gjendja faktike e vërtetuar:

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata administruar provat materiale në shkresat e lëndës dhe atë: Kontratën e punës nr. 112/15 e datës 17.09.2013, Njoftimin nga Komuna e Prishtinës datë 06.10.2015, Vendimin nga MASHT i datës 03.05.2016, Vendimi nr. 03/48 i datës 04.06.2014, Vendimi nr. 2114 i datës 07.07.2016, Njoftimin nga Komuna e Prishtinës datë 02.02.2017, Parashtresën e paditëses e datës 29.05.2018, Vendimin nr. 13473/18 i datës 17.01.2018, Aktvendimin CP.nr.1256/16, nga Gjykata Themelore e Prishtinës, Ekspertiza financiare e datës 24.10.2019 dhe plotësimin e ekspertizës financiare të datës 28.09.2023.

Pas administrimit të provave materiale në shkresat e lëndës dhe dëgjimit të pretendimeve të palëve, gjykata arriti të vërtetoi gjendjen faktike si vijon:

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestueses rrethana se paditësja ka qenë në marrëdhënie te punës tek e paditura e sistemuar në pozitën mësimdhënëse e lëndëve të stomatologjisë pranë SHMM ‘‘Dr.Ali Sokoli’’ Prishtinë, sipas kontratës së punës nr. 112/15 në kohë të caktuar deri me datë 31.08.2014, si dhe në fillim të vitit shkollor 2014/2015 për shkak të riorganizimit të brendshëm të klasave dhe drejtimeve / ndryshimit të profilit arsimor të njëjtës i është ndërprerë marrëdhënia e punës respektivisht ka mbetur pa orë mësimore. Mirëpo në bazë të procedurave administrative të zhvilluara paditësja është kthyer në vendin e punës të cilin e ka patur pranë SHMM ‘‘Dr.Ali Sokoli’’ Prishtinë.

Kontestuese nga pala e paditur është rrethana se paditëses nuk i takon e drejta e kompensimit të pagave për periudhën 01.09.2014 deri me datë 28.02.2018 me pretendimin se me vendimin me të cilën është kthyer paditësja në vendin e punës të njëjtës nuk i është njohur e drejta në kompensim të të ardhurave personale dhe se paditëses nuk i takon e drejta e kompensimit për faktin se ka pas kontratë të punës në kohë të caktuar.

Nga njoftimi i Komunës se Prishtinës datë 02.02.2017 dhe nga vendimi nga MASHT nr.100/05 i datës 03.05.2016, gjykata gjeti se Inspektorati i Arsimit ka gjetur si të pabazuar pretendimet e paditëses për përmirësim të dy notave në dy lëndë mësimore për 2 nxënës. Në bazë të këtij vendimi inspektori i arsimit ka gjetur se në librin e klasës X/1, viti kalendarik 2010/11, SHMM

Dr.Ali Sokoli, në rubrikën e vërejtjeve kujdestarja e klasës Besa Zeçiri ka evidentuar me kohë shënimin e saj duke konstatuar se ngritja e notave për dy nxënësit është bërë me pëlqimin e mësimitdhënëses lëndore H.B, këtu paditësja respektivisht në marrëveshje dhe me pëlqim të plotë nga e njëjta. Andaj për këtë vit kalendarik 2010/11 përkatësisht klasën X/1, paditësja pranë drejtorit të shkollës dhe këshillit të arsimtarëve dhe organeve tjera arsimore të shkollës nuk ka pas ankesë, në prani të këtyre rrethanave në fund të vitit shkollor sukcesi i këtyre nxënësve pa asnjë vërejtje është miratuar nga organet qeverisëse dhe profesionale, andaj mbi bazën e këtij vendimi pretendimet se pa autorizim të paditëses janë ngritur notat për 2 nxënës janë gjetur si të pabazuara rrjedhimisht ankesa është refuzuar.

Lidhur me çështjen se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës respektivisht ka mbetur pa orë mësimore e njëjta ka paraqitur ankesë pranë të paditurës dhe nga njoftimi i Komunës së Prishtinës datë 06.10.2015, gjykata gjeti se paditësja është njoftuar se i është shqyrtuar ankesa dhe Komuna e Prishtinës me datë 01.10.2015 ka kërkuar mbështetje nga Inspektorati i MASHT-it, që së bashku me një inspektor nga MASHT-i të bëjnë inspektim të përbashkët për të vërtetuar pretendimet e paditëses. Ndërsa nga vendimi nr. 2114 i datës 07.07.2016 gjykata gjeti se Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm e MASHT-it ka miratuar ankesën e paditëses dhe ka obliguar Drejtorinë e SH.M.M Dr.Ali Sokoli dhe DKA Prishtinë që paditësen ta kthej në vendin e punës si mësimitdhënëse e lëndëve të stomatologjisë.

Nga Aktvendimi CP.nr.1256/16 i nxjerrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës, gjykata gjeti se mbi bazën e dokumentit përmbarues- vendimit administrativ të MASHT nr.2114 i datës 07.07.2016, është lejuar propozimi për përmbarim i këtu paditëses për kthim në vendin e punës. Pas zhvillimit të procedurës përmbarimore, paditësja ka patur sukses në ekzekutimin e vendimit lidhur me kthim në vendin e punës dhe nga Komuna e Prishtinës përmes Vendimit 14-030/01-13473/18, të datës 17.01.2018 është aprovuar urdhri përmbarimor i Gjykatës Themelore në Prishtinë për kthim të paditëses në vendin e punës si mësimitdhënëse e lëndëve të stomatologjisë në SHML Ali Sokoli Prishtinë dhe paditësja është kthyer në vendin e punës.

Në bazë të propozimit të paditëses, gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e financave me ekspert financiar FK , i cili duke vepruar sipas aktvendimit të kësaj gjykate ka bërë llogaritjen e pagave, kontributit pensional dhe tatimit në pagë duke filluar nga data 01.09.2014 deri me datë 28.02.2018, ku për këtë periudhë eksperti ka bërë kalkulimin e pagave të papaguara nga e paditura për periudhën prej 01.09.2014 deri me 31.08.2015 në lartësi prej 50% të pagës bazë dhe 50% të kamatës, pasi që 50% e paditura i'a ka paguar paditëses vullnetarisht, ndërsa prej datës 01.09.2015 deri me datë 28.02.2018 ka bërë llogaritjen e plotë të pagës në shumë 454.77€.

Nga ekspertiza financiare e datës 24.10.2019 gjykata gjeti se paga për muajin Shtator 2014 paditëses i është paguar në tërësi, ndërsa paga e muajit Tetor 2014 nuk i është paguar fare, ashtu që për periudhën 01.09.2014 deri me datë 31.08.2015 për 50% të pagave të papaguara e paditura i ka mbetur paditëses borxh shumë prej 3,077.04€ neto, kontributet pensionale për punëdhënësin shumë prej 178,65€, tatimin në pagë shumë prej 317.23€ si dhe kamata për këtë periudhë arrin lartësinë prej 1,111.25€. Ndërsa prej datës 01.09.2015 deri me datë 28.02.2018

lartësia e pagave të papaguara arrin lartësinë neto 9,796.57€, kontributet pensionale nga punëdhënësi shumën 571.60€, tatimi në pagë shumën prej 1,063.84€, ndërsa kamata arrin lartësinë prej 3,380.19€.

Me qëllim të eliminimit të vërejtjeve të dhëna nga gjykata e Apelit, në rigjykim gjykata e ka kthyer në plotësimi ekspertizën financiare të përpiluar nga eksperti FK duke kërkuar nga eksperti që ta plotësoj të njëjtën ashtu që të verifikoj se paditësja HB në periudhën kontestuese prej datës 01.09.2014 deri me datë 28.02.2018 a ka pasur ndonjë marrëdhënie tjetër të punës të themeluar apo ka ushtruar profesionin e stomatologes tek ndonjë punëdhënës tjetër dhe nga plotësimi i ekspertizës financiare të datës 28.09.2023, gjykata gjeti se paditësja në periudhën kontestuese nuk ka qenë e punësuar tek ndonjë punëdhënës tjetër përkatësisht nuk ka realizuar të ardhura tjera nga ushtrimi i profesionit si stomatolog tek ndonjë punëdhënës tjetër, përveç pagave të paguara në lartësi prej 50% nga e paditura deri në Gusht të vitit 2015. Po ashtu gjykata në mbështetje të nenit 362.1 të LPK-së, e ka ftuar ekspertin FK në seancën e datës 31.10.2023 i cili drejtpërdrejt ka dhënë sqarime dhe përgjigje në pyetjet e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse.

Mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar si më lart, gjykata gjeti se paditësja ka ofruar prova të mjaftueshme që dërguan në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Deri tek ky përfundim kjo gjykatë ka ardhur duke u bazuar në atë baza juridike e kërkesëpadisë gjegjësisht fakti se paditësja është lënë pa orë mësimore kështu duke iu ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë kundërligjore, është vërtetuar nga vendimi nr.2114. i datës 07.07.2016 i lëshuar nga MASHT, me të cilin e paditura është detyruar që ta kthej në vendin e punës paditësen, si mësimdhënëse e lëndeve të Stomatologjisë. Ndër të tjera me këtë vendim konstatohet se e paditura në rastin e paditëses nuk ka vepruar sikurse në paralelet e farmacisë, kështu duke e diskriminuar të njëjtën në raport me mësimdhënëset tjera.

Duke qenë se paditësja me vendimin e lartcekur në procedurën administrative është kthyer në punë, e njëjta në këtë procedurë gjyqësore ka kërkuar kompensimin e të ardhurave personale. Gjykata vlerëson se si rezultat ndërprerjes së kundërligjshme të kontratës së punës respektivisht mbetjes pa orë mësimore të paditëses, të njëjtës i është shkaktuar dëm material për shkak të mos realizimit të pagave të cilat për ndryshe do t'i realizonte, andaj e paditura, duke mos e kryer detyrimin lidhur me respektimin e rregullave ligjore për shpërndarjen e orëve mësimore, rezulton se i ka shkaktuar dëm paditëses në emër të pagesës së pagave për periudhën nga data 01.09.2014 deri me datë 28.02.2018.

Me dispozitën e nenit 55 par.1 të Ligjit të Punës, është paraparë se: *“I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*. Sipas dispozitës ligjore një nga të drejtat themelore të të punësuarit është e drejta në pagë, prandaj në këtë rast paditëses i takon e drejta në pagë dhe të ardhurave tjera të cilat nuk i ka realizuar për shkak të ndërprerjes në mënyrë joligjore të kontratës së punës respektivisht mbetjes pa orë mësimore.

Meqenëse në rastin konkret nuk është kontestuese se paditëses në mënyrë joligjore i është ndërprerë marrëdhënia e punës respektivisht është lënë pa orë mësimore, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga vendimi i MASHT me të cilin është kthyer paditësja në vendin e punës, gjykata shqyrtoi kërkesëpadinë e paditëses vetëm sa i përket kompensimit të të ardhurave personale. Lidhur me lartësinë e këtyre kompensimeve gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i falur besimin ekspertizës së ekspertit financiar FK , ku eksperti ka konstatuar se për periudhën kohore nga data 01.09.2014 deri me datë 31.08.2015 për 50% të pagave të papaguara e paditura i ka mbetur paditëses borxh shumë prej 3,077.04€ neto, kontributet pensionale për punëdhënësin shumë 178,65€, tatimin në pagë shumë prej 317.23€. Ndërsa prej datës 01.09.2015 deri me datë 28.02.2018 lartësia e pagave të papaguara arrin lartësinë neto 9,796.57€, kontributet pensionale nga punëdhënësi shumë 571.60€, tatimi në pagë shumë prej 1,063.84€. E që në total rezulton se obligimet e të paditurës ndaj paditëses në emër të pagave të pa paguara për periudhën kohore nga data 01.09.2014 e gjer me datën 28.02.2018, arrijnë shumë prej 12,837.61 Euro, në emër të kontributit pensional në shumë prej 750.25 Euro, si dhe në emër të tatimit në pagë në shumë prej 1,381.07 Euro.

Gjykata shqyrtoi edhe kundërshtimin e të paditurës se paditësja ka patur kontratë të punës në kohë të caktuar dhe se me vendimin me të cilin paditësja është kthyer në vendin e punës nuk i është njohur e drejta e realizimit të kompensimit të të ardhurave personale por vetëm kthimi në vend të punës. Gjykata këto kundërshtime të të paditurës i vlerësoj si të pa bazuara për vendosje ndryshe në këtë çështje, për faktin se përderisa paditëses i është njohur e drejta e kthimit në vendin e punës për shkak se në mënyrë të kundërligjshme ka mbetur pa orë mësimore, të njëjtës i është krijuar edhe baza juridike për realizimit të të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës në lartësi sikurse i ka realizuar para ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ashtu siç janë cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa në raport me kontratën e punës në kohë të caktuar gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësja ka patur kontratë të punës në kohë të caktuar, mirëpo dihet mirëfilli se kontratat e punës në arsim në atë kohë janë lidhur në kohë të caktuar për të gjithë mësimdhënësit pa dallim, dhe të njëjtat janë vazhduar çdo vit për çdo mësimdhënësi në bazë të orëve mësimore që i kanë patur në dispozicion.

Në anën tjetër në rastin e paditëses edhe përkundër faktit se me nenin 4 par.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.22/2013 – Numri Maksimal i Nxënësve për Klasë dhe Raporti Mësimdhënës - Nxënës përcaktohet: *“Numri i nxënësve për paralele për shkollat e mesme profesionale për mësim teorik është 32 nxënës për klasë/paralele, ndërsa maksimumi një paralele mund ti ketë 35 nxënës”*, dhe faktit se në atë kohë kur paditësja është lënë pa orë, Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Dr. Ali Sokoli”, në Prishtinë, ka patur mbi 50 nxënës në paralele, fakt ky që vërtetohet edhe nga vendimi i MASHT nr.2114, dt.07.07.2016, e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, fare nuk ka ndërmarr asnjë masë për të parandaluar largimin e saj nga puna, përkatësisht nuk e ka zbatuar vendimin e saj 03 Nr.48, të datës 04.06.2014, për mënyrën dhe kriteret e sistemimit të tepricës teknologjike.

Me vendimin në fjalë të të paditurës 03 Nr.48, të datës 04.06.2014, i cili ka filluar ka filluar që të zbatohet që nga data 01.09.2014, përcaktohet qartë: *“Me qëllim të reduktimit maksimal të numrit të mësimeve të kualifikuar të shkollave të mesme të larta (SHML) të Komunës së Prishtinës që mbesin tepricë teknologjike si rezultat i shuarjes së klasëve të XII-a, ndërmerren këto masa: 1. Të gjitha SHML planifikojnë të regjistrojnë numër më të madh të paraleleve në klasët e X-a, për vitin shkollor 2014/2015, se sa vitin e kaluar, në përputhje me kapacitetet infrastrukturore të shkollës. 2. Të gjitha SHML që kanë klasë ekzistuese me më shumë se 35 nxënës në klasë krijojnë paralele të reja, në përputhje me kapacitetet infrastrukturore të shkollës. 3. Të gjitha SHML Profesionale e reduktojnë numrin e nxënësve në 16-19 nxënës në klasë vetëm për nevoja të realizimit të mësimit praktik. 4. Në secilën shkollë mblidhet totali i orëve mësimore të të njëjtës lëndë dhe pjesëtohet me numrin e mësimeve të asaj lëndë, dhe nëse në bazë të kësaj rezulton së të gjithë mësuesit kanë nga 18 e më shumë orë mësimore, atëherë veprohet sipas këtij parimi. 5. Nëse një mësues mbetet me fond të vogël të orëve, në ndërkohë që mësuesit e të njëjtës lëndë e kanë normën e plotë (20 orë mësimore), atëherë mësuesit me normë të plotë ju merren deri në 2 orë nga norma, në mënyrë që mësuesit me fond të vogël të orëve t'i rritet fondi i orëve. 6. Të gjithë ata mësuesit që mbesin tepricë teknologjike e që i kanë kualifikimet përkatëse sistemohen në shkollat e mesme të ulëta në momentin që lirohen vende të lira. Nëse edhe pas ndërmarrjes së masave të sipërpërmendura sërish mbetet tepricë teknologjike atëherë veprohet sipas parimit që mësuesi i cili është punësuar i fundit në shkollë mbetet tepricë teknologjike.”.*

Në anën tjetër vendimi i MASHT nr.2114, dt.07.07.2016, vërtetohet e paditura nuk e ka zbatuar vendimin e saj në raport me paditësen, sikurse ka vepruar me mësuesit në paralelet e farmacisë, kështu duke e diskriminuar të njëjtën, ngase e paditura nuk ka ndërmarr asnjë veprim me qëllim të krijimit të paraleleve të reja për lëndët e stomatologjisë me qëllim të krijimit të orëve edhe për paditësen, ashtu sikurse kishte vepruar me mësuesit e paraleleve të farmacisë. Andaj, nga këto arsye gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses gjen bazë ligjore edhe në dispozitën e nenit 80 par.1 pika 1.2 të Ligjit të Punës.

Andaj meqenëse në procedurë administrative është vendosur lidhur me ligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për paditësen respektivisht është gjetur se pa bazë ligjore paditësja është lënë pa orë mësimore, gjykata e ka gjetë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit të pagave, ashtu që nga këto arsye edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 01.07.2016, dita e paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për përpilimin e ekspertizës financiare në shumën prej 150 Euro dhe plotësimin e saj në shumën 100.00 Euro, apo në total shumën prej 250.00 Euro.

Numri i lëndës: 2019:286112  
Datë: 17.11.2023  
Numri i dokumentit: 04934399

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -  
C.nr.3994/23, datë 17.11.2023

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.